

“I Am He”

By President Jeffrey R. Holland
Acting President of the Quorum of the Twelve Apostles

“Unë Jam”

Nga Presidenti Xhefri R. Holland,
President Veprues i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

October 2024 general conference

Christ's charity—evident in complete loyalty to divine will—persisted and continues to persist.

It is the Sabbath day, and we have gathered to speak of Christ and Him crucified. I know that my Redeemer lives.

Consider this scene from the last week of Jesus's mortal life. A multitude had gathered, including Roman soldiers armed with staves and strapped with swords. Led by officers from the chief priests who had torches in hand, this earnest company was not off to conquer a city. Tonight they were looking for only one man, a man not known to carry a weapon, receive military training, or engage in physical combat at any time in His entire life.

As the soldiers approached, Jesus, in an effort to protect His disciples, stepped forth and said, “Whom seek ye?” They replied, “Jesus of Nazareth.” Jesus said, “I am he. ... As soon ... as he had said unto them, I am he, they went backward, and fell to the ground.”

To me, that is one of the most stirring lines in all of scripture. Among other things, it tells me straightforwardly that just being in the presence of the Son of God—the great Jehovah of the Old Testament and Good Shepherd of the New, who bears no weapons of any kind—that just hearing the voice of this Refuge from the Storm, this Prince of Peace, is enough to send antagonists stumbling into retreat, piling them in a jumble, making the whole group wish they had been assigned kitchen duty that night.

Just a few days earlier, when He had entered

Dashuria hyjnore e Krishtit, e dukshme në besnikërinë e plotë ndaj vullnetit hyjnor, vijoi dhe vazhdon të vijojë.

Është dita e Shabatit dhe ne jemi mbledhur për të folur për Krishtin dhe faktin që u kryqëzua. E di, jeton Shëlbuesi im.

Merreni parasysh këtë skenë nga java e fundit e jetës në vdekshmëri të Jezusit. Ishte mbledhur një turmë që përfshinte ushtarë romakë, të armatosur me shkopinj e me shpata në brez. I udhëhequr nga të dërguarit e krerëve të priftërinjve me pishtarë në duar, ky grup i zellshëm nuk po shkonte të pushtonte një qytet. Sonte ata po kërkonin vetëm një burrë, një njeri që nuk dihej të mbante armë, të kishte bërë stërvitje ushtarake ose të kishte marrë pjesë ndonjëherë në dyluftim fizik në gjithë jetën e Tij.

Kur ushtarët u afruan, Jezusi, në një përpjekje për të mbrojtur dishepujt e Tij, doli përpara dhe tha: “Kë kërkonin?” Ata iu përgjigjën: ‘Jezusin Nazareas’. Jezusi u tha atyre: ‘Unë jam!’ ... Sapo ai u tha atyre: ‘Unë jam’, ata u zmbarsën dhe ranë për dhe.”

Për mua, ky është një nga rreshtat më emocionues në të gjithë shkrimin e shenjtë. Ndër të tjera, më thotë drejtpërdrejt sethjesht të qenit në praninë e Birit të Perëndisë – Jehovahës të madhërishëm të Dhiatës së Vjetër dhe Bariut të Mirë të Dhiatës së Re, i cili nuk mban armë të asnjë lloji – qethjesht të dëgjuarit e zërit të këtij Strehimi kundër Stuhisë, të këtij Princi të Paqes mjafton për t'i bërë kundërshtarët të pengohen duke u tërhequr, të bien të ngatërruar mbi njëri-tjetrin duke bërë që i gjithë grupi të dëshirojë që t'i ishin caktuar detyra në kuzhinë atë natë.

Vetëm pak ditë më parë, kur Ai kishte hyrë

the city triumphantly, “all the city was moved,” the scripture says, asking, “Who is this?” I can only imagine that “Who is this?” is the question those muddled soldiers were now asking!

The answer to that question could not have been in His looks, for Isaiah had prophesied some seven centuries earlier that “he hath no form nor comeliness; and when we shall see him, there is no beauty that we should desire him.” It certainly wasn’t in His polished wardrobe or His great personal wealth, of which He had neither. It could not be from any professional training in the local synagogues because we have no evidence that He ever studied at any of them, though even in His youth He could confound superbly prepared scribes and lawyers, astonishing them with His doctrine “as one having authority.”

From that teaching in the temple to His triumphant entry into Jerusalem and this final, unjustifiable arrest, Jesus was routinely placed in difficult, often devious situations in which He was always triumphant—victories for which we have no explanation except divine DNA.

Yet down through history many have simplified, even trivialized our image of Him and His witness of who He was. They have reduced His righteousness to mere prudishness, His justice to mere anger, His mercy to mere permissiveness. We must not be guilty of such simplistic versions of Him that conveniently ignore teachings we find uncomfortable. This “dumbing down” has been true even regarding His ultimate defining virtue, His love.

During His mortal mission, Jesus taught that there were two great commandments. They have been taught in this conference and will forever be taught: “Love the Lord thy God [and] love thy neighbour as thyself.” If we are to follow the Savior faithfully in these two crucial and inextricably linked rules, we ought to hold firmly to what He actually said. And what He actually said was, “If ye love me, keep my commandments.” On that same evening, He said we were to “love one another; as I have loved you.”

In those scriptures, those qualifying phrases

në qytet ngadhënjimtar, “gjithë qyteti [ishte] ngrit[ur] në këmbë”, – thotë shkrimi i shenjtë, duke pyetur: “Kush është ky?” E vetmja gjë që mund të mendoj, është se “Kush është ky?” është pyetja që po bënin tani ata ushtarë të hutuar!

Përgjigjapër atë pyetje nuk mund të ishte në pamjen e Tij, sepse Isaia kishte profetizuar rreth shtatë shekuj më parë se ai “nuk kishte figurë[,] as bukuri për të tërhequr shikimin tonë, as paraqitje që ne ta dëshironim”. Sigurisht që nuk ishte në veshjet e Tij luksoze ose në pasurinë e madhe vetjake, prej të cilave nuk kishte asnjërin. Nuk mund të ishte nga ndonjë përgatitje profesionale në sinagogat e zonës, sepse ne nuk kemi asnjë provë që Ai studioi ndonjëherë në ndonjërin prej tyre, megjithëse edhe në rininë e Tij ai mund t’i ngatërronte skribët dhe doktorët e ligjit që ishin jashtëzakonisht të përgatitur, duke i mahnitur me doktrinën e Tij “si një që k[ishte] autoritet”.

Nga ai mësim në tempull deri tek hyrja e Tij ngadhënjimtare në Jerusalem dhe ky arrestim përfundimtar e i pajustifikuar, Jezusi u vu zakonisht në situata të vështira, shpesh dinake në të cilat Ai që gjithmonë ngadhënjyes, fitore për të cilat nuk kemi ndonjë shpjegim përveç ADN-së hyjnore.

Prapëseprapë gjatë historisë, shumë njerëz e kanë thjeshtuar, madje ia kanë ulur vlerën përfytyrimit tonë për Të dhe dëshmisë së Tij për atë që Ai ishte. Ata e kanë zvogëluar ndershmërinë e Tij duke e quajtur thjesht maturi, drejtësinë e Tij thjesht zemërim, mëshirën e Tij thjesht tolerancë. Ne nuk duhet të [bëhemi] fajtorë për variante të tilla të thjeshtuara të Tij, të cilat i shpërfillin volitshëm mësimet që na duken të parehatshme. Ky “thjeshtëzim” ka qenë i vërtetë edhe në lidhje me virtytin e Tij kulmor, përcaktues – dashurinë e Tij.

Gjatë misionit të Tij në vdekshmëri, Jezusi dha mësim se kishte dy urdhërime të mëdha. Ato janë dhënë mësim në këtë konferencë dhe do të jepen mësim përgjithmonë: “Duaje Zotin, Perëndinë tënd... [dhe] duaje të afërmin tënd porsì vetveten”. Nëse duam ta ndjekim me besnikëri Shpëtimtarin në këto dy rregulla thelbësore dhe të lidhura pazgjidhshmërisht, ne duhet t’i përmbahemi fort asaj që Ai tha në tëvërtetë. Dhe ajo që Ai tha në tëvërtetë, ishte: “Nëse më doni, zbatoni urdhërimet e mia”. Të njëjtën mbrëmje, Ai tha se ne duhej ta “doni[m] njëritjetritin, sikurse [Ai na] ka... dashur”.

Në ato shkrime të shenjta, ato frazat kual-

defining true, Christlike love—sometimes referred to as charity—are absolutely essential.

What do they define? How did Jesus love?

First, He loved with “all [of His] heart, might, mind and strength,” giving Him the ability to heal the deepest pain and declare the hardest reality. In short, He is one who could administer grace and insist on truth at the same time. As Lehi said in his blessing to his son Jacob, “Redemption cometh in and through the Holy Messiah; for he is full of grace and truth.” His love allows an encouraging embrace when it is needed and a bitter cup when it has to be swallowed. So we try to love—with all of our heart, might, mind, and strength—because that is the way He loves us.

The second characteristic of Jesus’s divine charity was His obedience to every word that proceeded from God’s mouth, always aligning His will and behavior with that of His Heavenly Father.

When He arrived on the Western Hemisphere following His Resurrection, Christ said to the Nephites: “Behold, I am Jesus Christ. ... I have drunk out of that bitter cup which the Father hath given me, ... in the which I have suffered the will of the Father ... from the beginning.”

Of the myriad ways He could have introduced Himself, Jesus did so by declaring His obedience to the will of the Father—never mind that not long before in His hour of greatest need, this Only Begotten Son of God had felt totally abandoned by His Father. Christ’s charity—evident in complete loyalty to divine will—persisted and continues to persist, not just through the easy and comfortable days but especially through the darkest and most difficult ones.

Jesus was “a man of sorrows,” the scriptures say. He experienced sadness, fatigue, disappointment, and excruciating loneliness. In these and in all times, Jesus’s love faileth not, and neither does His Father’s. With such mature love—the kind that exemplifies, empowers, and imparts—ours will not fail either.

So, if sometimes the harder you try, the more difficult it seems to get; if, just as you try to work on your limitations and your shortcomings, you find someone or something determined to

ifikuere që përcaktojnë dashurinë e vërtetë si të Krishtit, së cilës nganjëherë i referohemi si dashuri hyjnore, janë absolutisht thelbësore.

Çfarë përkufizojnë ato? Si deshi Jezusi?

Së pari, Ai deshi “me gjithë zemrën, fuqinë, mendjen dhe forcën [e Tij]”, gjë që i dha aftësinë për të shëruar dhembjen më të thellë dhe për të shpallur realitetin më të vështirë. Shkurt, Ai është personi që mundej të administronte hirin dhe në të njëjtën kohë të këmbëngulte tek e vërteta. Sikurse tha Lehi në bekimin e të birit, Jakobit: “Shëlbimi vjen nëpërmjet Mesias së Shenjtë; pasi ai është plot hir dhe vërtetësi”. Dashuria e Tij lejon një përqafim zemërdhënës kur është i nevojshëm dhe një kupë të hidhur kur duhet të gëlltitet. Pra, ne përpiqemi të duam – me gjithë zemrën, fuqinë, mendjen dhe forcën tonë – sepse ajo është mënyra se si Ai na do ne.

Karakteristika e dytë e dashurisë hyjnore dhe të shenjtë të Jezusit, ishte bindja e Tij ndaj çdo fjalë që dilte nga goja e Perëndisë, duke e përputhur përherë vullnetin dhe sjelljen e Tij me atë të Atit të Tij Qiellor.

Kur Ai mbërriti në këtë hemisferë perëndimore pas Ringjalljes së Tij, Krishti u tha nefitëve: “Vini re, unë jam Jezu Krishti. ... Unë kam pirë nga ajo kupë e hidhur që Ati më dha ... kështu unë kam plotësuar vullnetin e Atit ... që nga fillimi.”

Nga një pafundësi mënyrash se si Ai mund ta kishte paraqitur veten, Jezusi e bëri këtë duke shpallur bindjen e Tij ndaj vullnetit të Atit – megjithëse jo shumë kohë më parë, në kohën kur Ai kishte nevojë më tepër, ky Bir i Vetëmlindur i Perëndisë ishte ndier i braktisur plotësisht nga Ati i Tij. Dashuria hyjnore e Krishtit, e dukshme në besnikërinë e plotë ndaj vullnetit hyjnor, vijoi dhe vazhdon të vijojë, jo vetëm në ditët e lehta dhe të rehatshme, por veçanërisht në ato më të errëtat dhe më të vështirat.

Jezusi ishte një “njeri i dhembjeve”, – thonë shkrimet e shenjtë. Ai përjetoi trishtim, lodhje, zhgënjim dhe vetmi torturuese. Në këto kohë dhe në të gjitha, dashuria e Jezusit nuk dështon dhe as e Atit të Tij. Me një dashuri të tillë të pjekur, të llojit që mishëron, fuqizon dhe jep, nuk do të dështojë as e jona.

Pra, nëse ndonjëherë sa më shumë që përpiqeni, aq më të vështira duken se bëhen [gjërat]; nëse, pikërisht teksa po përpiqeni të punoni mbi kufizimet dhe mangësitë tuaja, gjeni

challenge your faith; if, as you labor devotedly, you still feel moments of fear wash over you, remember that it has been so for some of the most faithful and marvelous people in every era of time. Also remember that there is a force in the universe determined to oppose every good thing you try to do.

So, through abundance as well as poverty, through private acclaim as well as public criticism, through the divine elements of the Restoration as well as the human foibles that will inevitably be part of it, we stay the course with the true Church of Christ. Why? Because as with our Redeemer, we signed on for the whole term—not ending with the first short introductory quiz but through to the final exam. The joy in this is that the Headmaster gave us all open-book answers before the course began. Furthermore, we have a host of tutors who remind us of these answers at regular stops along the way. But of course, none of this works if we keep cutting class.

“Whom seek ye?” With all our hearts we answer, “Jesus of Nazareth.” When He says, “I am he,” we bow our knee and confess with our tongue that He is the living Christ, that He alone atoned for our sins, that He was carrying us even when we thought He had abandoned us. When we stand before Him and see the wounds in His hands and feet, we will begin to comprehend what it meant for Him to bear our sins and be acquainted with grief, to be completely obedient to the will of His Father—all out of pure love for us. To introduce others to faith, repentance, baptism, the gift of the Holy Ghost, and receiving our blessings in the house of the Lord—these are the fundamental “principles and ordinances” that ultimately reveal our love of God and neighbor and joyfully characterize the true Church of Christ.

Brothers and sisters, I testify that The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints is the vehicle God has provided for our exaltation. The gospel it teaches is true, and the priesthood legitimizing it is not derivative. I testify that Russell M. Nelson is a prophet of our God, as His predecessors were and as His successors will be. And one day that prophetic guidance will lead a generation to see our Messenger of Salvation descend

dikë ose diçka të vendosur për ta sfiduar besimin tuaj; nëse, ndërsa punoni me përkushtim, ende ndieni se ju pushtojnë çaste frike, mos harroni se kështu ka qenë për disa njerëz mrekullisht besnikë në çdo epokë të kohës. Mos harroni gjithashtu se ka një forcë në univers të vendosur për të kundërshtuar çdo gjë të mirë që përpiqeni të bëni.

Pra, si në bollëk, dhe në varfëri, si në vlerësimin veças, dhe në kritikën publike, si në elementet hyjnore të Rivendosjes, dhe në dobësitë njerëzore që do të jenë pashmangshmërisht pjesë e saj, ne qëndrojmë [besnikë] në këtë drejtim me Kishën e vërtetë të Krishtit. Pse? Sepse, ashtu si Shëlbuesi ynë, ne hodhëm firmën për të gjithë kursin, që nuk mbaron pas testit të parë e të shkurtër hyrës, por deri në provimin përfundimtar. Gëzimi në këtë gjë qëndron te fakti se Drejtori i Shkollës na i dha të gjitha përgjigjet haptas përpara se të fillonte kursi. Për më tepër, ne kemi një mori mësuesish që na i kujtojnë këto përgjigje në ndalesa të rregullta përgjatë udhës. Por sigurisht, asnjëra nga këto nuk funksionon mirë nëse vazhdojmë ta lëmë orën e mësimit.

“Kë kërkon?” Me gjithë zemrën tonë ne përgjigjemi: “Jezusin Nazareas”. Kur Ai thotë: “Unë jam”, ne e përkulim gjurin dhe rrëfejmë me gojën tonë se Ai është Krishti i gjallë, se vetëm Ai shleu për mëkatet tona, se Ai po na mbartte edhe kur mendonim se na kishte braktisur. Kur të qëndrojmë përpara Tij dhe të shohim plagët në duart dhe këmbët e Tij, do të fillojmë të kuptojmë se çfarë donte të thoshte për Tëqë të mbante mëkatet tona dhe të njihej me pikëllimin, të ishte plotësisht i bindur ndaj vullnetit të Atit të Tij, gjithçka nga dashuria e kulluar për ne. T’i njohim të tjerët me besimin, pendimin, pagëzimin, dhuratën e Frymës së Shenjtë dhe marrjen e bekimeve tona në shtëpinë e Zotit – këto janë “parimet dhe ordinancat” themelore që zbulojnë në fund dashurinë tonë për Perëndinë dhe të afërmin dhe karakterizojnë me gëzim Kishën e vërtetë të Krishtit.

Vëllezër dhe motra, dëshmoj se Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme është mjeti që Perëndia ka siguruar për ekzaltimin tonë. Ungjilli që ajo jep mësim, është i vërtetë dhe priftëria që e përligj atë, nuk është derivat. Dëshmoj se Rasëll M. Nelsoni është një profet i Perëndisë tonë, siç ishin pararendësit e Tij dhe siç do të jenë pasrendësit e Tij. Dhe një ditë, ai udhërrëfim profetik do ta udhëheqë një

like “lightning ... out of the east,” and we will exclaim, “Jesus of Nazareth.” With arms forever outstretched and love unfeigned, He will reply, “I am he.” I so promise with the apostolic power and authority of His holy name, even Jesus Christ, amen.

brez për të parë Lajmëtarin tonë të Shpëtimit të zbresë si “vetëtima ... nga lindja” dhe ne do të thërrasim: “Jezusi Nazareas!” Me krahët e shtrirë përgjithmonë dhe me dashuri të pashtirur, Ai do të përgjigjet: “Unë jam”. Kështu premtoj me fuqinë dhe autoritetin apostolik të emrit të Tij të shenjtë, madje Jezu Krishtit, amen.